REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1543/1 Prot Tiranë, më 17/06/2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE, ELBASAN

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.164, datë 05.10.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.560, datë 26.07.2024 "Për mënyrën e emërimit, transferimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës" dhe shkresës me nr.898 prot, datë 11.06.2026 "Kërkesë për shpalljen e pozicionit vakant" të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Elbasan, protokolluar në AKPA me nr.1543 prot, datë 15.06.2026, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Elbasan, brenda datës 18.06.2026, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

Specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Elbasan.

1. **Kritere të përgjithshme:**
   a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
   b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
   c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kritere të posaçme:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare "Bachelor".
b) të ketë njohuri të përditësuar të teknologjisë së informacionit.
c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

3. Dokumentet e aplikimit:

a. letërmotivimi për pozicionin;
b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë,Kulturës dhe Informacionit nr.560, datë 26.07.2024 "Për mënyrën e emërimit, transferimit dhe lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës";
c. kartën e identitetit;
d. diplomën dhe listën e notave;
e. librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
f. çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
g. certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j. vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë punë).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe, si dhe të jenë të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Elbasan.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s, brenda datës 26.06.2026.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë zhvillohet si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:

i. arsimimi: 20 pikë;

ii. njohuritë në fushën e TIK- ut: 20 pikë;

- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;

- Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.

- Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:

a. Ligji nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar;
b. Ligji nr. 146/2015 "Për punëkërkuesit"
c. VKM nr.17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit ne punë dhe praktikave profesionale"; i ndryshuar;
d. VKM nr.348, datë 29.04.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit", i ndryshuar;
e. VKM nr.535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet";
f. VKM nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar
g. VKM nr.161, datë 21.03.2018 "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia", i ndryshuar;
h. VKM nr.837, datë 28.10.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit" i ndryshuar;

ii. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

- Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
- Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA